



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

N J O F T I M

Datë 08.10.2021

Në bazë të nenit 179/8 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit Nr. 95/2016 “Për Oganizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” dhe të nenit 48 pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit Nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë“, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall sot fillimin e procedurave për plotësimin e 2 (dy) pozicioneve vakante në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (këtej e tutje Prokuroria e Posaçme).

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ju bën thirrje që të kandidojnë të gjithë prokurorët që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Kanë ushtruar funksionin si prokuror për jo më pak se 10 vjet;¹
- Nuk kanë masa disiplinore në fuqi;²
- Japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;³
- Sigurojnë pëlqimin e anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;⁴

Në bazë të nenit 6/1/a të Ligjit për Nr. 95/2016, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, pas dorëzimit të aplikimeve, kandidatët do t’i nënshtrohen verifikimi të pasurisë dhe figurës.⁵

Në rast se numri i kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore është më i madh se numri i vendeve vakante, Këshilli do të shqyrtojë kandidimet dhe do të vlerësojë/rendisë kandidatët përkundrejt kritereve të mëposhtme:

¹ Sipas nenit 47/2/c të ligjit për Statusin.

² Sipas nenit 48/8 të ligjit për Statusin.

³ Sipas nenit 6/1/b të ligjit për SPAK.

⁴ Sipas nenit 6/1/c të ligjit për SPAK.

⁵ Kandidatët që e kanë kaluar me sukses vetting-un përpara datës së dorëzimit të aplikimeve, konsiderohen se e plotësojnë këtë kusht. Emrat e kandidatëve që nuk e kanë kaluar ende vetting-un i përcillen menjëherë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për kryerjen e verifikimeve të parashikuara nga ligji i vetting-ut (neni 57/11 i ligjit Nr. 95/2016, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”).

- Rezultatet e kandidatëve në 2 vlerësimet e fundit të performancës;
- Përvoja e kandidatëve në pozicionet e komanduara;
- Përvoja e kandidatëve në hetimin e krimit ekonomik dhe krimit të organizuar (pranë Njësive të Përbashkëta Hetimore/NJPH, Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Drejtorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit Ekonomik në Prokurorinë e Përgjithshme/PP);
- Kohëzgjatja e shërbimit në NJPH, Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe ose Drejtorinë kundër Korrupsionit dhe Krimit Ekonomik në PP.
- Vjetërsia si prokurorë

Sipas nenit 48/14 të ligjit Nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar rregulla të detajuara për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme. Këto rregulla janë publike dhe te njohura tashme përpara fillimit të procesit të shpalljes për shprehje interesi për aplikime nga kandidatë për prokurorë në Prokurorisë së Posaçme. (rregullorja gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Këshillit)⁶

Kandidatët që plotësojnë kushtet e sipërpërmendura i paraqesin kërkesat e tyre deri me datë 23.10.2021.

Krahas kërkesës për kandidim, kandidatët dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Një letër motivimi (jo më shumë se 3 faqe A4) ku tregojnë sukseset e tyre më të spikatura në hetimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe arsyet e kandidimit;
2. Një CV të përditësuar;
3. Formularët e parashikuar në shtojcat B1 dhe B3 të ligjit 95/2016 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar" të plotësuar rregullisht;
4. Çdo dokumentacion tjetër që kandidati vlerëson.
5. Kopje të Vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit apo Kolegjit të Apelit nëse kandidati për prokuror në Prokurorinë e Posaçme ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit;

Aplikimet do të dorëzohen në formë elektronike në adresën: karriera@klp.al (në këtë rast të gjitha dokumentet e sipërpërmendura duhet të jenë të skanuara) ose në formë fizike në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Ana Komnena", godina "Poli i Drejtësisë", Ish Fusha e Aviacionit, Tiranë.

⁶ Rregullorja mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar